



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:065486  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05738319

KPPP.nr. 1606/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka BPB Sh.A, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson “Debt Loan Recovery” L.L.C., me seli në Pejë, rr. “Mbretëresha Teutë”, nr. 16, kundër debitorëve 1. L.Th., me numër personal ... dhe me adresë në Klinë, ...; 2. B.Sh., me numër personal ... dhe me adresë në Pejë, rr. “...”, nr. 53; dhe 3. H.G., me numër personal ... dhe me adresë në Klinë, fshati ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve B.Sh. dhe H.G. të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1/2019, i lejuar me datë 11.01.2019, nga Përmbaruesi Privat Sefer Arifi me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të debitorëve B.Sh. dhe H.G. të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1/2019, i lejuar me datë 11.01.2019, nga Përmbaruesi Privat Sefer Arifi.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Pejë.

A r s y e t i m

Kreditori Banka BPB, me datë 30.01.2019, pranë Gjykatës Themelore në Pejë, ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorëve L.Th., B.Sh. dhe H.G., me bazë përmbarimi sipas titullit ekzekutiv.

Ndaj urdhrit përmbare, debitorët H.G. dhe B.Sh. të autorizuar kanë paraqitur prapësim ndërsa Gjykata Themelore në Pejë, me Aktvendimin EP.nr. 299/19, të datës 19.02.2020 ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit H.G. të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbare P.nr. 1/2019, të datës 11.01.2019.

Ndaj këtij aktvendimi debitori H.G. ka paraqitur ankesë, ndërsa Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 83/23, të datës 05.09.2023, ka aprovuar ankesën e debitorit si të bazuar, ndërsa lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Në rivendosje, gjykata pas shqyrtimit paraprak të propozimit për përmbare dhe shkresave të lëndës, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje, për arsyet si në vijim:

Gjykata gjen se në rastin konkret çështja përmbare zhvillohet në mes të kreditorit si person juridik dhe debitorëve në cilësi të personave fizik, lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit mbi bazën e dokumentit përmbare - marrëveshjes mbi kredinë, ndërsa me nenin 13, paragrafi 1, pik 1.1 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, ndërsa me pikën 1.2 të të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi juridik, ndërsa në cilësinë e debitorëve janë paraqitur persona fizik.

Ndërsa, nisur nga fakti se adresa e debitorit të prapësimit B.Sh. është në Pejë, në mbështetje të nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare i cili përcakton se *“Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbare sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaresi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka*

*vendbanim ne Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi”, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Pejë.*

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë, në mbështetje të dispozitave nga neni 17 dhe 19, lidhur me nenin 387.1, pika u) dhe 392, pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1606/23, datë 27.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.